


REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRIUT - ZYRA E PREMIERIT - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Numri i dokumentit / Dokument No. / Doc. No. / 01	Numri i Dosit / Dosier No. / Doc. No. / 1059/9
Numri i faqes / Faqja / Page / - PO -	Data / Datum / Date / 10 / 04 / 2018
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*  
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*  
*Ministry of Regional Development*

---

RAPORTI 100 DITORË I ZËVENDËS MINISTRES NË  
MINISTRINË E ZHVILLIMIT RAJONAL

MAGBULE SHKODRA

---

*Prill 2018*

## Përmbajtja

1.Hyrje .....	2
2.Aktivitetet e Zëvendës Ministres .....	3
3.Përfundim .....	8

## 1.Hyrje

Me vendim Nr. 2274 të datës 11.09.2017 të Kuvendit të Republikës së Kosovës është themeluar Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR). Me datë 02.10.2017 Kryeministri Ramush Haradinaj emëroi znj.Magbule Shkodra Zëvendës Ministre në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Kjo ministri ka për qëllim eliminimin e disbalancit socio-ekonomik të vendit dhe zhvillimin e të gjitha rajoneve pa dallim, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, në përkrahje të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar dhe krijimit të vendeve të reja të punës, MZHR në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe me institucionet tjera, koordinon edhe aktivitete për zhvillimin e zonave ekonomike me qëllim të promovimit dhe zhvillimit socio – ekonomik të balancuar.

Fushëveprimi i kësaj ministrie nënkupton zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton ndonjë organizim të ri administrativ apo territorial.

## 2. Aktivitetet e Zëvendës Ministres

Në 100 ditët e para të vitit 2018 Zëvendës Ministria e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal Magbule Shkodra ka realizuar vizita në 11 (njëmbëdhjetë) Komuna të Republikës së Kosovës. Në kuadër të lansimit të projekteve për investime kapitale, grante/subvencione, që drejtpërdrejt ndikojnë në zhvillim ekonomik dhe mirëqenie të qytetarit të Kosovës Znj. Shkodra vizitoi Komunat : Suharekë, Rahovec, Deçan, Junik, Obiliq, Gjakovë, Gjilan, Viti, Kamenicë, Ranillugë dhe Klinë.

Me datë 05.01.2018 Zëvendës Ministria znj. Shkodra vizitoi Komunën e Suharekës, me ç'rast u prit nga kryetari i kësaj komune z. Bali Muharremaj. Zëvendës Ministria dhe z. Muharremaj biseduan për mundësinë e bashkëpunimit në mes të nivelit qendror dhe lokal, me anë të implementimit të projekteve të ndryshme, për mirëqenien e qytetarëve.

Më tutje zëvendës Ministria vazhdoi me vizitë në Komunën e Rahovecit, për t'u takuar me kryetarin e kësaj komune z. Smajl Latifi, me të cilin u dakorduan që për të krijuar një mirëqenie për qytetin e Rahovecit, do të fillojë bashkëpunimi në mes të Komunës së Rahovecit dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Me datë 10.01.2018 Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra vizitoi Komunën e Deçanit. Kryetari i kësaj komune z. Bashkim Ramosaj e priti zv.Ministren dhe njëherit shprehi gadishmërinë për të bashkëpunuar, me qëllimin e vetëm që të krijohet një rjet më i mirë i punës për qytetarët pa dallim.

Vizita e Zëvendës Ministres vazhdoi pastaj në Komunën e Junikut, me ç'rast u prit nga kryetari i komunës z. Agron Kuçi. Zëvendës Ministria znj. Shkodra dhe kryetari z. Kuçi, biseduan për projektet të cilat janë të rëndësishme për banorët e komunës së Junikut e të cilat mund të përkrahen nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Me datë 11.01.2018 Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra vizitoi Komunën e Obiliqit, me ç'rast u prit nga kryetari i kësaj komune z. Xhafer Gashi. Znj. Shkodra dhe z. Gashi u dakorduan për një bashkëpunim të ndërsjellë në mes të Komunës së Obiliqit dhe MZHR-së, për të krijuar mundësi të reja të punës dhe implementimit të projekteve të ndryshme në të mirë të qytetarëve.

Me datë 12.01.2018 Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra vizitoi Komunën e Gjakovës, ku zhvilloi takim me Kryetarin e kësaj komune z. Ardian Gjini. Zëvendës Ministria dhe kryetari Gjini biseduan për mundësitë që mund t'u krijonin qytetarëve për të implementuar projektet e tyre dhe mundësitë e punësimit për ta.

Me ftesë të znj. Eranda Baçi, drejtoreshë ekzekutive e Organizatës Jo-qeveritare "Inciativa e femrës Kosovare" me seli në Gjakovë, Zëvendës Ministria, znj. Shkodra vazhdoi vizitën e saj në këtë organizatë, ku u prit nga drejtoresha znj. Baçi dhe stafi punues i organizatës. Zëvendës Ministria dhe znj. Baçi biseduan për mundësinë e përkrahjes së kësaj organizate, ku do të përfitonin gratë dhe vajzat në përgjithësi, duke u krijuar për to vende të reja të punës. Zëvendës Ministria znj. Shkodra dhe znj. Baçi u pajtuan se pozita e gruas, vajzës në përgjithësi është në gjendje jo të mirë dhe duhet një bashkëpunim konkret i të gjithë mekanizmave të shoqërisë me qëllim të arritjes së rezultateve të pozitive.

Me datë 15.01.2018 Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra vizitoi Komunën e Gjilanit, për t'u takuar me kryetarin e kësaj komune z. Lutfi Haziri. Z. Haziri e priti në takim Zëvendës Ministrin dhe në bisedë e sipër u dakordua me znj. Shkodra që të fillojnë bashkëpunimin me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, për të realizuar projekte të ndryshme, që do t'a ndihmonin drejtpërdrejt qytetarin.

Zëvendës Ministria vazhdoi takimet e saj në Komunën e Vitisë, me ç'rast u prit nga kryetari i komunës z. Sokol Haliti, i cili e falënderoi Zëvendës Ministrin për gadishmërinë që kishte shprehur për t'a vizituar komunën e tyre dhe për mundësinë për të bashkëpunuar me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal. Zëvendës Ministria dhe z. Haliti ranë dakord që të punojnë dhe realizojnë projekte që do të kishin ndikim pozitiv tek qytetarët.

Me datë 16.01.2018 Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra realizoi vizitë në Komunën e Kamenicës për t'u takuar me kryetarin e kësaj komune z. Qëndron Kastrati. Zëvendës Ministria dhe kryetari z. Kastrati biseduan për mundësitë për të krijuar vende të punës për qytetarët dhe për t'a përmisuar mirqenien e tyre. Të dyja palët u pajtuan se komuna e Kamenicës si pjesë e rajonit lindor është një ndër komunat ku ka negecje të zhvillimit ekonomik. Dakordimi dhe kordinimi efikas në mes të nivelit qendror dhe lokal mund t'a ndihmojnë Kamenicën drejt zhvillimit ekonomik.

Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra vazhdoi me vizitën e saj në Komunën e Ranillugës. Në takim u prit nga kryetari i komunës z. Vladica Artonoviç me të cilin bisedoi për mundësitë e bashkëpunimit që të krijohen mundësi të reja të punës për të gjithë qytetarët pa dallim.

Me datë 19.01.2018, me kërkesë të profesoreshës znj. Mariana Gandić, Zëvendës Ministria znj. Shkodra, ka pritur në takim 20 (njëzet) student nga nacionalitete të ndryshme të botës, të cilët studionin "Të drejtat e njeriut" në dy programe paralele Master në Vienë dhe Venedik.

Të interesuar për gjendjen politike dhe ekonomike në Kosovë, znj. Shkodra i informoi se aktualisht Kosova udhëhiqet nga Kryeministri Ramush Haradinaj, i cili me të marrë në dorë qeverisjen e shtetit, ka sjellur një frymë të re të zhvillimit të vendit në përgjithësi.

Me datë 25.01.2018 Zëvendës Ministria znj. Shkodra, ishte pjesë e delegacionit të Kryeministrit të Kosovës z.Ramush Haradinaj, me të cilin realizuan vizitë zyrtare në Komunën e Gjilanit, me ç' rast u pritën nga kryetari i komunës z. Lutfi Haziri. Pas takimit me kryetarin, drejtorët, asambleistët dhe qytetarët e kësaj komune, vizita e tyre vazhdoi në kompaninë e lëngjeve " Fluidi " dhe industrinë e vajit ushqimor "Floil". Ngritja e kapaciteteve ekonomike dhe krijimi i vendeve të reja të punës ndodhin vetëm duke i mbështetur pa rezervë, bizneset tona vendore.

Me datë 29.01.2018 në Prishtinë, Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra në bashkëpunim me Ministrin, Zëvendës Ministrat dhe znj. Mrika Gashi, drejtoreshë e ARDA-s në Qendër, mbajtën sesion informues në kuadër të lansimit të Skemës së Granteve "Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar", me përfituesit potencial/ bizneset dhe qytetarët, me qëllim të informimit lidhur me këtë program dhe mundësitë e aplikimit.

Me datë 01.02.2018 znj.Shkodra vizitoi komunën e Pejës me ftesë të kryetarit z.Gazmend Muhaxheri. Zëvendës ministria e siguroi kryetarin se MZHR do të përkrahë, në kuadër të mundësive buxhetore të kategorisë së investimeve kapitale, komunën e Pejës. Më tutje znj.Shkodra vazhdoi takimin gjegjësisht sesionin informues me qytetarët e komunës së Pejës, me qëllim të informimit lidhur me skemën e granteve. Zëvendës Ministria vazhdoi vizitën në Agjencionin Zhvillimor - Perëndim me seli në Pejë. Në takim drejtoresha e Agjencionit znj.Leman Hatashi e informoi Zëvendës Ministren për aktivitetin e tyre dhe bashkëpunimin me komunat e rajonit perëndimorë. Zëvendës Ministria premtoi se problemet me të cilat ballafaqohen të gjitha Agjencionet Zhvillimore Rajonale në Kosovë do t'i adresojë me kohë.

Me datë 02.02.2018 Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra vazhdoi sesionin informues në komunën e Gjilanit, në kuadër të lansimit të Skemës së Granteve " Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar " , ku ishte e pranishme edhe drejtoresha e AZHR-së, znj. Valbona Tahiri. Ky sesion informues u mbajt me qytetarë dhe përfaqësues të bizneseve të vogla dhe të mesme , të cilët u informuan për mundësitë e aplikimit dhe realizimit të projekteve dhe ideve të tyre.

Me datë 08.02.2018 znj.Shkodra pas takimit me kryetarin e Deçanit z.Bashkim Ramosaj zhvilloi një sesion informues me gratë/vajzat e komunës së Deçanit. Në këtë sesion informues znj.Shkodra në mënyrë të detajuar sqaroi skemën e granteve të lansuar nga MZHR.

Me qëllim të përkrahjes së më tutjeshme të zhvillimit rajonal Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra zhvilloi takim me Ministrin e Infrastrukturës z. Pal Lekaj. Në takim me Ministrin Lekaj, u dakorduan që të targetojnë vendet të cilat kanë nevojë për krijimin e një rrjeti më të mirë infrastrukturor, një mbështetje kjo, që do të u'a mundësonte qytetarëve lëvizjen më të shpejt e në veçanti bizneseve që të kenë një zhvillim më të hovshëm në ngritjen e kapacitetit të punës.

Gjatë muajit Shkurt 2018 Zëvendës Ministria znj. Shkodra, kishte realizuar vizitë zyrtare, dy ditore në Tiranë. Fillimisht ajo realizoi takim me Ambasadorin e Kosovës në Tiranë, z. Sylë Ukshini. Në takim u diskutua për funksionimin e Ambasadës së Kosovës atje, punën dhe angazhimet e Ambasadës për qytetarët, si dhe për bashkëpunim të ndërsjellë në mes të Ambasadës dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Më pastaj, për të zgjeruar bashkëpunimin Kosovë - Shqipëri, Zëvendës Ministria znj. Shkodra është takuar edhe me përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, z. Engjëll Agaci, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, znj. Majlinda Dhuka, Drejtore e Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, z. Rezar Sako, Drejtor i Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik, z. Shpëtim Quku dhe Arben Skënderaj, Drejtorë të Agjencive për Zhvillim Rajonal për Shkodrën dhe Tiranën, z. Benet Peci, Drejtor i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Në këtë vizitë kishte pajtueshmëri që t'u ipet përparësi zbatimit të programeve për bashkëpunim ndërkufitar Kosovë – Shqipëri.

Me datë 01.03.2018, Zëvendës Ministria znj. Magbule Shkodra zhvilloi takim me përfaqësuesin e Komisionit Evropian z. Luigi Brusa, me të cilin bisedoi që të vazhdojë përkrahjen financiare për 5 (pesë) Agjencionet e Zhvillimit Rajonal (Veri, Jug, Lindje, Perëndim dhe Qendër ), në projektet e ndryshme për rritjen e vendeve të punës. Në takim znj. Shkodra e bëri të qartë se Agjencionet e Zhvillimit Rajonal janë dorë e djathtë e komunave të Kosovës dhe MZHR-së.

Përgjatë kësaj periudhe, Zëvendës Ministria me ftesë të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, mori pjesë në (5) pesë vjetorin e themelimit të këtij Universiteti, të cilët kishin organizuar ceremoni për nder të themelimit dhe njëherit shpërblyen me dekorata studentët e dalluar në drejtimet që studioheshin në këtë Universitet. Pas përfundimit të kësaj ceremonie Zëvendës Ministria vazhdoi takimet e saj edhe me stafin akademik të Universitetit " Kadri Zeka ", për t'u njoftuar më gjerësisht për punën dhe aktivitetet e tyre, të cilët ishin të fokusuar në avancimin e sistemit arsimor me qëllim të zhvillimit ekonomik të vendit.

Ka vazhduar procesi i implementimit të aktiviteteve të Zëvendës Ministres, ku me ftesë të West Minster Foundation(WMF) e ka përfaqësuar Kosovën në Konferencën Ndërkombëtare " Violence Against Women In Politics " në Londër.

Më tutje takimet e saj vazhduan në Ambasadën e Kosovës në Londër, ku u prit nga Ambasadori z. Lirim Greçevci. Znj. Shkodra zhvilloi një takim me komunitetin shqiptar, bizneset e vogla e të mëdha që vepronin në Londër, e të cilat shprehën gatishmërinë e të bërit investime në Republikën e Kosovës, si dhe sigurinë e investimeve. Në funksion të realizimit të vizitës Zëvendës Ministria znj. Shkodra zhvilloi takim të karakterit politik dhe ekonomik me Lord Sheikh nga House of Lords dhe znj. Lady Guli Muradova me të cilët bisedoi për mundësinë e financimeve dhe investimeve, me qëllim të arritjes së përafrimit të biznesit vendor me partnerë të huaj. Znj. Shkodra kërkoi nga znj. Guli që t'i përkrahte gratë dhe vajzat kosovare të cilat merren me punimin e artizanateve, që puna e tyre të promovohet edhe në tregjet ndërkombëtare dhe t'u krijohen mundësi më të mëdha të rritjes së kapacitetit të punës.

Me rastin e festimit të përvjetshëm të Pashkëve, festës së Ringjalljes, Zëvendës Ministria znj. Shkodra vizitoi Katedralen " Shën Nënë Tereza " në Prishtinë, ku zhvilloi takim me Ipeshkvin e Ipeshkvisë Imzot Dodë Gjergji. Duke i'u uruar festën e madhe të Pashkëve, znj. Shkodra uroi që të gjithë njerëzit në Kosovë t'a kërkojnë me sinqeritet të vërtetën dhe të gjejnë durimin për zgjidhjen e mospajttimeve.

Në bashkëpunim me Ministrin dhe Zëvendës Ministrat kanë përmbyllur me sukses lansimin për projekte kapitale në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me bashkëfinancim me Komunitat e Republikës së Kosovës dhe skemën e granteve për fillimin dhe stabilizimin e bizneseve, një përkrahje buxhetore nga ana e Ministrisë për një zhvillim socio - ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës dhe vazhdimësinë e pozitive ekzistuese.



### 3.Përfundim

Ministria e Zhvillimit Rajonal falë bashkëpunimit të mirëfillt të stafit të kabinetit të Ministrit dhe Zëvendës Ministrave, do të vazhdojë me zhvillim edhe më të hovshëm të punës dhe aktiviteteve.

Në MZHR pas lansimit të skemave të investimeve kapitale dhe granteve kemi pranuar kërkesa të shumta të cilat buxheti i Ministrisë e ka të pamundur t'i adresojë, përkundër faktit që ato konsiderohen se do të mund të eliminonin disbalancin socio-ekonomik në mbarë Kosovën.

Andaj, Ministria e Zhvillimit Rajonal kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që në rishikimin e buxhetit për vitin 2018, të marrë përkrahje më të madhe buxhetore nga ana e Qeverisë në mënyrë që të mund të përkrahë më shumë, të gjitha rajonet komunale në gjithë territorin e Kosovës.

Me respekt

Magbule Shkodra

